



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 4

27 janar

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 21, datë 22.1.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.....	69
Vendim i KM nr. 22, datë 22.1.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 725, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë”	69
Vendim i KM nr. 23, datë 22.1.2014	Për përfaqësimin e Federatës së Sindikatave të punonjësve të Shëndetësisë së Shqipërisë dhe të Urdhrit të Mjekut në përbërje të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.....	70
Vendim i KM nr. 24, datë 22.1.2014	Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të Ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave të paregjistruar.....	71
Vendim i KM nr. 26, datë 22.1.2014	Për miratimin e garancive qeveritare, të lëshuara në favor të Intesa San Paolo Bank Albania dhe bankës Societe Generale Albania, në kuadër të kushteve të kontratave përkatëse të kredisë ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a.....	72
Vendim i KM nr. 28, datë 22.1.2014	Për shfuqizimin e vendimit nr. 591, datë 1.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për zhvillimin e një projekti koncesionar në zonat, plazh Dhërmi dhe plazh Perivoll, me karakter turistik, panoramik dhe informues, ndërtimin e infrastrukturës përkatëse dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Eurokontakt” sh.p.k”	73

Vendim i KM nr. 29, datë 22.1.2014	Për largimin dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive.....	73
Urdhër i MZHUT nr. 5, datë 16.1.2014	Për delegim kompetencash për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël dhe lidhjen e kontratave të shërbimeve në përmbushje të procedurës së prokurimit dhe kontratave të tjera për shërbimet e aparatit të MZHUT-së.....	74
Urdhër i MZHUT nr. 7, datë 20.1.2014	Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit.....	74
Urdhër i MTI nr. 65, datë 20.1.2014	Për delegim kompetence.....	76

VENDIM
Nr. 21, datë 22.1.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1269, DATË 17.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E
PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR
SHQYRTIMIN E VLEFESHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË
MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i parë i pikës 1 të shkronjës “A” të kreut I “Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar të Tokës (KQT)”, të vendimit nr. 1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komisioni Qeveritar i Tokës kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe përbëhet nga:

- | | |
|---|------------------|
| - Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | zëvendëskryetar; |
| - Ministri i Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Ministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit | anëtar.”. |

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 22, datë 22.1.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 725, DATË 21.5.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, KOMPETENCAT DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT
TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARKEOLOGJISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 725, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) ka në përbërje përfaqësues të institucioneve të specializuara dhe personalitete të fushës së kulturës së trashëguar. Numri i anëtarëve të KKA-së është 11 (njëmbëdhjetë) veta. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë kryesohet nga ministri i Kulturës dhe ka në përbërje:

- | | |
|--|-----------|
| - Drejtorin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik | sekretar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor | anëtar; |



- Drejtorin e Trashëgimisë Materiale në Ministrinë e Kulturës anëtar;
 - Drejtorin e Institutit të Monumenteve të Kulturës anëtar;
 - Drejtorin e Institutit të Arkeologjisë anëtar;
 - 2 (dy) personalitete nga fusha e arkeologjisë, të përcaktuar nga ministri i Kulturës anëtar;
 - 1 (një) përfaqësues (arkeolog), i përcaktuar nga Instituti i Arkeologjisë, anëtar;
 - 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Arkeologjisë, në Universitetin e Tiranës anëtar;
 - 1 (një) përfaqësues nga grupet e interesit të fushës së arkeologjisë anëtar.
- Drejtori juridik i Ministrisë së Kulturës asiston në të gjitha mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pa të drejtë vote.”.

b) Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen, përkatësisht me “Ministria e Kulturës” dhe “ministri i Kulturës”.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 23, datë 22.1.2014

PËR PËRFAQËSIMIN E FEDERATËS SË SINDIKATAVE TË PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË SË SHQIPËRISË DHE TË URDHËRIT TË MJEKUT NË PËRBËRJE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronjat “dh” e “e” dhe 3 të nenit 16 të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Shëndetësisë së Shqipërisë, si përfaqësuese të sindikatës së të punësuarve, në përbërje të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Përcaktimin e Urdhrit të Mjekut, si përfaqësues të organizatës së profesionistëve të shëndetësisë, në përbërje të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 24, datë 22.1.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT TË MINISTRIT
TË SHËNDETËSISË PËR IMPORTIMIN E BARNAVE TË PAREGJISTRUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr. 9323, datë 25.1.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për përballimin e gjendjeve emergjente (katastrofa natyrore, epidemi) ose në rast nevojash të shërbimit shëndetësor (alternativa të vetme barnash për mjekim ambulator, spitalor), ministri i Shëndetësisë lëshon autorizim për importimin e barnave të paregjistruar.

2. Kërkesa për autorizim importi për çdo bar të paregjistruar paraqitet pranë Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, nga subjektet e licencuara për importimin e barnave. Në kërkesën për t’u pajisur me autorizimin përkatës për importimin e barnave të paregjistruar, për çdo bar të paregjistruar duhet të përcaktohen: emri, principi aktiv, doza dhe forma farmaceutike, sasia, çmimi për njësi i barit, emri dhe adresa e mbajtësit të autorizimit për hedhjen në treg të barit dhe/ose firma prodhuese, si dhe një përshkrim i shkurtër për përdorimin e barit.

3. Autorizimi për importimin e barnave të paregjistruar jepet vetëm për ata barna, që nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave.

4. Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, publikon në faqen zyrtare të kësaj ministrie, adresën elektronike të kontaktit për çdo komunikim të nevojshëm lidhur me procedurën e dhënies së autorizimit për importimin e barnave të paregjistruar.

5. Autorizimi për importimin e barnave të paregjistruar është i vlefshëm për një periudhë dymujore nga koha e lëshimit dhe jepet kundrejt një tarife prej 5000 (pesë mijë) lekësh për çdo bar.

6. Drejtoria Farmaceutike, përpara lëshimit të autorizimit të importimit për barin, ka të drejtë të verifikojë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti importues, pranë autoriteteve apo subjekteve private ose publike, nga ku ato janë lëshuar.

7. Inspektorati i Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, përpara fillimit të procedurës së zhdoganimit për barin përkatës, kërkon nga subjekti importues, përveç autorizimit të ministrit të Shëndetësisë për importimin e barnave të paregjistruar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, edhe këto dokumente:

- a) faturat (invoice) e barit, për të cilin është bërë kërkesa së bashku me të dhënat për sasi;
- b) certifikatën e cilësisë për çdo seri të barit;
- c) certifikatën e origjinës së barit.

8. Dokumentacioni i përmendur në pikën 7 të këtij vendimi, ruhet nga Inspektorati i Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, i cili njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me anë të një autorizimi të veçantë.

9. Barnat e paregjistruar, pasi zhdoganohen sipas rregullave në fuqi, pajisen me pullën e kontrollit nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

10. Të gjitha autorizimet e importimit të barnave të paregjistruar, që jepen nga Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, publikohen në faqen zyrtare të kësaj ministrie, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e lëshimit të tyre.

11. Çmimi i barit, për të cilin është dhënë autorizim importi, nuk duhet të ndryshojë për një periudhë 1-vjeçare nga data e hyrjes së barit në Republikën e Shqipërisë. Përrjashtimisht, brenda vitit do të pranohet kërkesa dhe do të lëshohet autorizim vetëm për importimin e barnave me çmim të njëjtë ose më të ulët se ai i deklaruar për herë të parë në atë vit.



12. Miratimin e formatit të autorizimit të importimit për barnat e paregjistruar, sipas modelit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

MINISTRI
AUTORIZIM IMPORTIMI

Nr. _____, datë _____

Mbështetur në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, nenet 11 dhe 48, autorizohet _____ sh.p.k., Tiranë, me drejtues teknik Z.Y.Z. të importojë barnat e paregjistruar, si më poshtë:

Nr.	Emri i barit	Lënda vepruese	Formë/doza	Sasi	Çmimi	Firma prodhuese
1						
2						
3						

Autorizimi është i vlefshëm për një importim dhe me afat prej 2 (dy) muajsh.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

VENDIM
Nr. 26, datë 22.1.2014

PËR MIRATIMIN E GARANCIVE QEVERTARE, TË LËSHUARA NË FAVOR TË INTESA SAN PAOLO BANK ALBANIA DHE BANKËS SOCIETE GENERALE ALBANIA, NË KUADËR TË KUSHTEVE TË KONTRATAVE PËRKATËSE TË KREDISË NDËRMJET KËTYRE BANKAVE DHE KESH SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancive qeveritare, të lëshuara në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe bankës Societe Generale Albania, në kuadër të kushteve të kontratave të kredisë për importin e energjisë elektrike ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a., për shumat, si më poshtë vijon:

a) Për kontratën e kredisë që do të lidhet ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe KESH sh.a., për shumën 1 000 000 000 (një miliard) lekë.

b) Për kontratën e kredisë që do të lidhet ndërmjet bankës Societe Generale Albania dhe KESH sh.a., për shumën ekuivalente në lekë të shumës 6 000 000 (gjashtë milionë) euro.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 28, datë 22.1.2014

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 591, DATË 1.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR
ZHVILLIMIN E NJË PROJEKTI KONCESIONAR NË ZONAT, PLAZH DHËRMI DHE
PLAZH PERIVOLL, ME KARAKTER TURISTIK, PANORAMIK DHE INFORMUES,
NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS PËRKATËSE DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË
“EUROKONTAKT” SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 591, datë 1.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për zhvillimin e një projekti koncesionar në zonat, plazh Dhërmi dhe plazh Perivoll, me karakter turistik, panoramik dhe informues, ndërtimin e infrastrukturës përkatëse dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Eurokontakt” sh.p.k.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 29, datë 22.1.2014

**PËR LARGIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, NË KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË
KREDIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Largimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

- znj. Odeta Kromici, teknikien;
- z. Elton Stafa, ekonomist;
- z. Hasan Metuku, jurist.



2. Emërimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

- znj. Kleopatra Maliqi, jurist;
- z. Gentian Opre, ekonomist;
- znj. Eda Luci, ekonomist.

3. Anëtarët e emëruar e ushtrojnë këtë detyrë deri në përfundim të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, sipas nenit 23 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar. Në çdo rast, ata nuk mund ta ushtrojnë këtë detyrë për një mandat mbi 3 (tre) vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR

Nr. 5, datë 16.1.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR PROCEDURAT E PROKURIMEVE ME VLERË TË VOGËL DHE LIDHJEN E KONTRATAVE TË SHËRBIMEVE NË PËRMBUSHJE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT DHE KONTRATAVE TË TJERA PËR SHËRBIMET E APARATIT TË MZHUT-së

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, sekretarit të përgjithshëm të MZHUT-së, z. Robert Gjini, për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël dhe lidhjen e kontratave të shërbimeve në përmbushje të procedurës së prokurimit dhe kontratave të tjera për shërbimet e aparatit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datën 31.12.2014.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

URDHËR

Nr. 7, datë 20.1.2014

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E Oponencës Teknike Për Projektet e Veprave të Ndërtimit

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, si dhe pikës 2, 4 të vendimit nr. 1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”,

URDHËROJ:

1. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit për të gjitha objektet publike që pajisen me leje zhvillimore ndërtimi, infrastrukture dhe komplekse,

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

2. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, për objekte që nuk janë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit ose Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

3. Subjektet që do të kryejnë oponencën teknike për projektet e veprave të ndërtimit, para kryerjes së oponencës, lidhin një marrëveshje me porositësin, sipas marrëveshjes tip bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Paga për oponencën teknike të projekteve të bëhet sipas pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

5. Urdhri nr. 49, datë 19.4.2011 i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

MARRËVESHJE TIP

E mbajtur sot në Tiranë, datë ____ . ____ . ____ , midis:

Porositësi: _____

Sipërmarrësi: _____

Të cilët, me qëllim krijimin e marrëdhënies juridike, bazuar në kreun VII, neni 850 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhin këtë marrëveshje me përmbajtje, që vijon:

Objekti i marrëveshjes: _____

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në momentin kur porositësi vë në dispozicion të sipërmarrësit të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij.

2. Sipërmarrësi në rast se nuk realizon oponencën brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të kësaj marrëveshjeje, i paguan porositësit 0.01% (për qind) të vlerës totale të projektit, për çdo ditë vonese.

3. Vleftha për realizimin e objektit sipas kësaj marrëveshje është _____ lekë, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr. 1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

4. Afati i dorëzimit të oponencës teknike pranë sipërmarrësit, do të jetë _____ ditë/muaj nga data e lidhjes së kësaj marrëveshjeje.

5. Në rast se gjatë realizimit të objektit lindin mosmarrëveshje, palët i zgjidhin ato me mirëkuptim midis tyre, në rast të kundërt i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për zgjidhje.

6. Paga e vlefthës për realizimin e oponencës kryhet në momentin e dorëzimit të saj te sipërmarrësi në numrin e llogarisë _____ dhe IBAN _____.

Klienti, brenda afatit dhe kushteve të marrëveshjes, duhet të realizojë oponencën teknike për projektin e veprës së ndërtimit _____.

7. Kjo marrëveshje hartohet në 3 kopje origjinale, me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve.

Porositësi

Znj./z. _____

Sipërmarrësi

Znj./z. _____

Shënim. *Sipërmarrësi do të jetë njëri nga subjektet e përcaktuara në urdhrin nr. _____, datë _____ të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.



URDHËR
Nr. 65, datë 20.1.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë